

## Adiafora e politikës në Kosovë (botuar në "Zëri", më 29 dhjetor 2011)

### 1. Pse duhet të merremi me politikë

Të traumatizuar në shekullin e kaluar nga politikat shtypëse të okupimit dhe nga politikat diktatoriale e serviliste të sistemit njëpartiak, ne, qytetarët e Kosovës, kemi nevojë për këndellje me shpejtësi, tash kur jemi të lirë nga okupimi dhe e gëzojmë një sistem shumëpartiak. Aderimi në parti politike dhe marrja me politikë duhet të kuptohet si akt i admirueshëm pozitiv, për shkak të ofertës së re ose begatimit të asaj ekzistuese dhe guximit për të hyrë në konkurrencë. Admirimi është i bazuar nëse në politikë hyjnë njerëz të cilët i rrisin ofertat sociale dhe zhvillimore, për të gjithë zgjedhësit. Të vetmit që nuk do të jenë të kënaqur nga kjo janë ata që nuk mund ta përballojnë konkurrencën.

Por, domosdo duhet sqaruar se konkurrencën në politikë nuk e përbën vetëm oferta programore, por edhe kredibiliteti i subjektit ofertues, si parti apo individ. Këto dy kualitete, oferta programore dhe kredibiliteti për zbatimin e saj, duhet të jenë bazë përcaktuese për zgjedhësit. Këto janë vlerat. Ndërkaq, çmuarja e vlerave i takon popullit, më saktësisht zgjedhësve.

Në Kosovë, fatkeqësisht, ka mbetur botëkuptimi i shekullit të kaluar, i dekurajimit të konkurrencës, sado kualitative të jetë ajo, dhe sado që është shumë e nevojshme për vendin tonë. Ende vazhdojnë të ushqehen përshtypjet, thellësisht të gabuara, se “të mirët nuk bën të merren me politikë se do të korruptohen (financiarisht, a shpirtërisht, a moralisht)”. E kush të merret me politikë? Ata që veç janë të korruptuar financiarisht dhe shpirtërisht dhe moralisht? Të tillëve t’ua lëmë në duar fatin e jetës sonë, fatin e shtetit tonë, ekonomisë, shëndetësisë, arsimit?

Ky botëkuptim, i dëmshëm por mjaft karakteristik për Kosovën, duhet elaboruar nga një mori pikëpamjesh. Logjikshëm shtrohet pyetja, pse shfaqet ky botëkuptim? Sepse, çdo politikë, qoftë edhe ajo e dobishme për qytetarin dhe për vendin është e keqe e përgjithshme; apo se çdokush që hyn në politikë altermohet, ndryshohet, nga një njeri me integritet në një njeri të denigruar, për shkak të terrenit të rrëshqitshëm; apo se hyrja e të mirëve në politikë e pavarëson politikën nga servilët pa kualitet dhe grupet e miniinteresave personale.

Ne përfundimisht duhet ta tejkalojmë sa më shpejtë botëkuptimin që e trajton politikën si adiaforë, si një pëllg ku konceptet morale, etike, virtytet e drejtësia ose mungojnë plotësisht,

ose janë koncepte ndaj të cilave politika është indiferente. Vaclav Havel, ish-presidenti çek, shkrimtar i mirënjohur dhe mik i vendit tonë, i cili ndërroi jetë tash së fundi, kishte thënë: “Nëse jeni modest dhe nuk jeni të etur për fuqi, jo vetëm që ju përshtatet politika, por ju absolutisht e keni vendin aty.” Në dritë të kësaj thënie del porosia që secili që ka integritet, të merret me politikë, të paktën deri në një stad tjetër, më të avancuar të Kosovës, për ta ndryshuar qoftë vetëm pak e më së miri rrënjësisht politikën aktuale patronazhiste në Kosovë. Kjo është mënyra për t’i ndihmuar vendit tonë dhe qytetarët tonë në këtë fazë.

## **2. Tejkalimi i frikësimit nga brenda**

Është e natyrshme që instanca e fundit e partive politike është marrja e pushtetit. Gara për pushtet është motiv pozitiv, nëse bëhet me mjete lojale dhe e bazuar në vlera. Nga fundi i viteve ‘80 dhe fillimi i viteve ‘90, në Kosovë vlerat janë definuar kryesisht nga nevoja që të respektohej e drejta e popullit tonë për t’u çliruar nga okupimi. Kjo kohë shënon edhe fillimin e partive politike post-komuniste. Që atëherë, falë angazhimit politik dhe të armatosur, Kosova, me mjaft mundime, e ka kaluar periudhën e dhunës nga jashtë.

Por, liria gjithmonë manifestohet si liri e jashtme dhe si liri e brendshme. Tash duhet ta kalojmë edhe periudhën e frikësimit nga brenda. Prandaj, është e nevojshme të fillohet hapja e një kaptine të re, e cila fillon me konsolidimin e demokracisë dhe me oferta konkrete partiake, për mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë. Na duhet demokracia, liria - jo vetëm kolektive, por edhe individuale, që përfshin mundësitë ekonomike - si dhe drejtësia. Kjo do të jetë politika e së ardhmes.

Politika e së ardhmes, nuk do të bëhet vetvetiu, nëse shumica rrinë duarkryq. Kosovarët duhet ta zhvillojnë atë, për një të ardhme në të cilën i jepet mundësia individit, pa marrë parasysh gjininë, komunitetin, fenë, apo dallime të tjera.

Liritë dhe vlerat individuale janë bazë e atyre shoqërore. Kosova e njeh rolin e individit nga historia e vet, rolin e atyre që u burgosën politikisht, rolin e atyre që u flijuan për Kosovën, dhe rolin e të tjerëve që u angazhuan në shumë forma për lirinë e vendit tonë. Tashmë, fatbardhësisht, është koha kur askush nuk duhet të sakrifkohet, as politikisht, përveçse në qoftë se sakrificë quhet humbja e privilegjeve të fituara pa meritë. Këta të kategorisë së fundit, mund të ndihen të rrezikuar nga konkurrenca dhe roli i individit, idetë e të cilit potencialisht mund të kolektivizohen. Për ndryshe, të gjithë të merituarit e dëshirojnë dhe i qëndrojnë

konkurrencës. Kriteret e shkruara dhe ato të pashkruara i krijon vet shoqëria. Kreativiteti dhe avancimi personal, pa i dëmtuar të tjerët, e avancojnë edhe shoqërinë.

### **3. Përgjegjësia për paratë e taksapaguesve**

Partitë politike janë bazë e funksionimit të sistemit përfaqësues në secilin shtet demokratik. Nëse, siç konsiderohen nga disa, partitë politike janë fëmijët e padëshiruar të demokracisë, atëherë në shtetin e Kosovës demokracia është nëna e padëshiruar e shumicës së partive politike. E shteti i Kosovës ka nevojë të forcohet. Që kjo të ndodhë, ai duhet të zvogëlohet. Jo me parti ose oferta, as me territor, por me burokraci, me departamente, me ministri. Nëse qeveritë me radhë kanë prodhuar të këqija elementare për qytetarë dhe nëse duam ta zvogëlojmë të keqen, atëherë duhet ta zvogëlojmë dhe jo vetëm ndryshojmë përbërjen e Qeverisë.

Nuk kanë faj disa qeveritarë që nuk e dinë numrin e zëvendësministrave. Por, ata kanë faj që emërojnë kaq shumë zëvendësministra. Ata mbajnë përgjegjësi që e dëmtojnë shtetin tonë të ri, i dëmtojnë paratë e qytetarëve. Ata thonë se dinë të menaxhojnë me paranë publike. Por, e kanë gabim për dy arsye: një se paratë publike nuk i shohin ashtu siç janë, si para të taksapaguesve e jo të qeveritarëve apo Qeverisë, dhe e dyta se deri tash kanë treguar zotësi vetëm të keqmenaxhojnë.

Nuk është vetëm çështja e shpenzimeve të parave të qytetarëve, tuajat, tonat, që vjen me një numër aq të madh ministrish, por sjellja shoqërore të cilën ato shpenzime e kushtëzojnë dhe krijojnë. Sjellja korruptive nxit abuzime dhe papërgjegjësi, për shembull, edhe në universitet e në institucione shtetërore, në kohën kur vendit i duhet përgjegjësi dhe llogaridhënie. Na duhet përgjegjësia e votuesve për ta dëshmuar nevojën e tyre për ndryshime transformuese, pa marrë parasysh manipulimet zgjedhore, dhe na duhet përgjegjësia e të votuarve, pa marrë parasysh trysninë eventuale ndërkombëtare.

### **4. Pavarësia si nocion pozitiv pune**

Sot, nuk ka nevojë t'ia dëshmojmë tjetërkujt se e meritojmë apo jo pavarësinë, sepse për ne, pavarësia do të thotë liri, por ka nevojë që ta vrojtojmë zhvillimin e shoqërisë përbrenda dhe të përcaktohen kahet e zhvillimit të mëtejshëm. Pavarësia nuk është koncept abstrakt, as utopik e as

izolues, por do të thotë aftësim për shfrytëzimin e potencialit vetanak për të projektuar dhe për t'i zbatuar ato projekte, me interes për individin dhe shoqërinë, në të gjitha përmasat e zhvillimit. Por, pavarësia nuk është vetëm një akt – akti i shpalljes. Ajo ndërtohet dhe forcohet në proces. Proceset e shtet-ndërtimit ndikojnë drejtpërdrejt në demokraci, e forcojnë ose dobësojnë atë.

Pavarësia e Kosovës u shpall në shkurt 2008, por varësia e saj kronike, po shpallet me çdo akt të papërgjegjshëm të disave në udhëheqjen tonë. Zgjedhjet e parregullta, mungesa e vendeve të punës, korrupsioni i lartë, krimi i organizuar i lidhur me anëtarë të legjislativit dhe ekzekutivit, arsimi e shëndetësia përtoke, e bëjnë Kosovën më të varur se që do të duhej të ishim që nga shpallja e pavarësisë. Për këtë varësi pjesën e vet të përgjegjësisë duhet ta marrin ata që vetproklamohen si sjellës të pavarësisë.

Për pavarësi të vërtetë ne na nevojitet mbështetja për opsionet e së ardhmes, që janë vizionare e të hapura e jo provinciale e të mbyllura, ato për paqe e liri e jo për dhunë e shtypje, për demokraci e jo autokraci. Na nevojitet mbështetja për drejtësi e jo shkelje të saj, për barazi të mundësive e jo për privilegje.

Zhvillimi i demokracisë në çdo vend, është i lidhur me zhvillimet në sistemin politik. Baza e atij zhvillimi është sistemi zgjedhor, përkatësisht natyra demokratike e sistemit dhe mënyra e zbatimit të tij. Në Kosovë, pandërmjetshëm, në lëmin e zgjedhjeve duhet ndërruar shumëçka, por së pari sjellja e bartësve dhe ekzekutuesve të tyre.

Efektet e deformimit të vullnetit të popullit janë të jenë të shumta, si përbrenda, nga aspekti i zhvillimit të gjithëmbarshtëm socio-ekonomik, si në pozicionin tonë relativ rajonal, ashtu edhe në synimet tona euro-atlantike. Efektet ndjehen edhe në stabilitetin e brendshëm në vend. Zgjedhja në mes të stabilitetit dhe demokracisë është një zgjedhje fals. Populli shqiptar, populli i Kosovës, është i orientuar me shumicë absolute nga perëndimi dhe kjo nuk do të ndërrojë. Dhe sikurse politika “standardet para statusit” që u tregua jorealiste, edhe tash politika “stabilitet para demokracisë” do të tregohet e pasuksesshme. Ne duhet ta kërkojmë stabilitetin përmes demokracisë, e jo në kurriz të demokracisë. Për këtë është e dobishme, edhe në aspektin ndërkombëtar, forcimi i demokracive në Ballkan. Sepse vetëm shtetet demokratike mund të bashkë-kontribuojnë për stabilitet të qëndrueshëm. Shtetet e Ballkanit duhet të pajtohen jo vetëm me fjalë por edhe me vepra se nuk ka asgjë më të rëndësishme sesa vendosja e shtetit ligjor.

## **5. Partitë politike duhet të kenë raport pozitiv me demokracinë**

Publikimi “Abetarja e pushtetit: Libërth mbi politikën, njerëzit dhe pushtetin” para disa ditësh nga Iniciativës Kosovare për Stabilitet (IKS) përmban një doracak informues për qytetarët lidhur me skenën politike kosovare. Aty janë mbledhur narrative të historikëve të partive politike, krahas të dhënave të tjera. Kjo është e dobishme sepse e informon qytetarin e një qytetar i informuar është bërthama e suksesit të një demokracie. Ky punim është ndër hapat e parë serioz për t’i observuar partitë politike tek ne. Do të ishte e dobishme, në të ardhmen, të studioheshin partitë për nga organizimi, demokracia e brendshme, ideologjia, financimi, aktivistët, baza mbështetëse, liderizmi, grupet e interesit dhe biznesit, grupet urbane, koalicionet, historia, votuesit, zgjedhjet kritike, sjellja në pushtet, etj. Do të na shërbenin edhe studimet krahasuese me rajon, Evropë dhe botë, si dhe krahasime ndërmjet niveleve komunale dhe nivelit qendror. Me interes do të ishin shqyrtimi i evoluimit të partive politike ose trendet e tyre, efektet e ndryshimeve demografike e teknologjike, e po ashtu kultura politike dhe karakteristikat e demokracisë kosovare në përgjithësi.

Në përfundim, nëse partitë politike janë organizata që grumbullojnë individë për një aksion kolektiv duke u nisur nga logjika e projektit, organizimit dhe mobilizimit për dobi shoqërore, në vendin tonë ende duhet promovuar logjika e projektit dhe duhet definuar qartazi dobitë shoqërore të cilat i artikulojnë partitë. Duhet spikatur se partitë politike luajnë një rol të rëndësishëm edhe në raport me shoqërinë civile, si ndërmjetës në mes të shoqërisë civile dhe shoqërisë politike.

Partitë politike në Kosovë, në përfaqësim, formim të udhëheqjes, rekrutim, formulim të qëllimeve, artikulum të interesave, socializim e mobilizim, si dhe në organizim të qeverisjes duhet të kenë raport pozitiv me demokracinë. Prandaj, pa marrë parasysh se a janë ato parti të kuadrove apo të masave, përfaqësuese apo integruese, kushtetuese apo revolucionare, të majta apo të djathta, ato duhet të kontribuojnë me konflikte idesh dhe njëkohësisht me integrim shoqëror në vendin tonë.

Në rrugën tonë, ne duhet që t’i përqafojmë vlerat e pranimit dhe mirëkuptimit, si vlera që mësohen jo vetëm në një komunitet, por duke komunikuar dhe bashkëpunuar me komunitete të tjera. Për këtë arsye, dhe për ta luftuar krimin, i cili nuk është i izoluar, edhe kur Kosova është, ne duhet të bëjmë progres të shpejtë dhe të qartë drejt standardeve dhe integritimit Evropo-Atlantik. Partitë politike janë qenësore në këtë rrugëtim.

(Shënim: Komente, të zgjeruara, me rastin e publikimit të punimit “Abetarja e pushtetit: Libërth mbi politikën, njerëzit dhe pushtetin”, nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), dhjetor 2011.)